



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2603 Prot.

Roskovec, më 30.03 2022

VENDIM

NR 20. DATË 29.03.2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR VENDIMMARRJEN ,PERFORMACËN DHE TRANSPARENCËN E KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2021**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, VKB Nr.19 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak Roskovec”si dhe VKB Nr.20 datë 27.03.2020 “Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike”nëni 43 i tij, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit për vendimmarjen, performancën dhe transparencën e Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2021.
2. Bashkëlidhur këtij vendimi “Raporti për vendimmarjen, performancën dhe transparencën e Këshillit të Bashkisë Roskovec për vitin 2021”.
3. Ngarkohet Sekretaria e Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 236f Prot.

Roskovec, më 23.03 2022

**RAPORT PËR VENDIMARRJEN ,PERFORMACËN DHE TRANSPARENCËN E  
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2021**

Të nderuar!

Këshilli i Bashkisë Roskovec për vitin 2021 ka pasur një aktivitet intensiv në vendimarrje dhe në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin. Edhe pse një vit i vështirë për shkak të pandemisë Covid-19, kemi mundur të arrijmë disa objektiva madhore në kryerjen e funksioneve duke u mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" si dhe legjislacioni sektorial përfusha të ndryshme të vetëqeverisjes vendore.

Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimarrës, përfaqësues dhe mbikqyrës/monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role me mundësitë disi të kufizuara në kohë pandemie por gjithësesi me angazhim dhe përkushtim.

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përbledhur të japim aktivitetet kryesore të zhvilluara sipas kategorive.


Në lidhje me rolin vendimarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:

Gjatë vitit 2021 janë realizuar në total 13 mbledhje të Këshillit, 12 prej tyre të radhës dhe 1 jashtë radhe me kërkësë të Kryetarit të Bashkisë.

Në total janë miratuar 109 vendime, 30 prej tyre ishin vendime me karakter normativ të cilat i kemi dërguar në Prefekturën e Qarkut Fier për konfirmim ligjor. Nga vendimet e dërguara në Prefekturë 5 vendime janë kthyer të pa konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, dhe Këshilli ka vazduar me procedurën ligjore duke i anuluar këto vendime. Nga vendimet e pakonfirmuara 4 vendime janë konfirmuar nga prefekti pasi janë rifutur në këshill dhe janë miratuar me ndryshimet përkatëse, 1 vendim është duke u shqyrtuar përsëri.

Janë realizuar disa mbledhje komisionesh, kryesisht Komisioni i Ekonomisë dhe Buxhetit. Komisionet e Këshillit duhet të janë aktive dhe duhet të mblidhen me inisiativën e tyre për cështjet që trajohen në këshill, sipas tematikës së cështjes.

Vlen të theksohet se Këshilli Bashkiak ka trajtuar dhe i ka dhënë zgjidhje një game të gjërë problematikash të komunitetit tonë në fusha të ndryshme si : për ndihmat ekonomike, për



shërbime ndaj komunitetit, investime ndaj komunitetit, për të ardhurat e veta, për fondet buxhetore, etj. Zgjidhja e këtyre problemeve vjen si rezultat i një bashkëpunimi shumë të mirë me Ekzekutivin dhe administratën e Bashkisë Roskovec, të cilët kanë si objektiv të përbashkët zgjidhjen në kohë dhe sipas ligjit gjithë shqetësimet dhe problematikat e komunitetit. Të gjitha vendimet e këshillit janë publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec.

2 mbledhje të Këshillit janë zhvilluar në transmetim live nëpërmjet faqes së facebook, cka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të jape dhe mendimet dhe sygjerimet e tij për vendimet dhe cështjet që janë shqyrtuar në ato mbledhje.

Gjithashtu gjatë vitit 2021 kemi miratuar një plan aktivitetesh të shoqëruar me buxhetin përkates tē dedikuar vetëm për Këshillin në mënyrë që të realizoheshin aktivitetet e planifikuara.

Për vitin 2021 sfida kryesore ishte implementimi i rregulloreve dhe planit të aktiviteteve në praktikë. Në bashkëpunim me këshilltarët, administratën dhe komunitetin kemi arritur zbatimin e planit të aktiviteteve në masën 70%.

Në procesin e shqyrtimit dhe implementimit të këtyre rregulloreve këshilli është asistuar nga Projekti "Bashki të Forta" i cili do vazhdojë edhe për këtë vit të asistojë për të bërë të mundur vazhdimin e implementimit të këtyre standardeve në mënyrë që të rritet roli i Këshillit të Bashkisë.

Në lidhje me rolin përfaqësues të këshillit për vitin 2021, si u theksua më sipër duke marrë parasysh situatën për shkak të pandemisë Covid-19, është synuar që komunikimi dhe marrja e mendimeve të komunitetit të realizohet nëpërmjet komunikimit kryesisht nëpërmjet publikimit dhe marrjes së mendimeve nëpërmjet rrjetave sociale. Për këtë qëllim faqja e Facebook-ut e Këshillit Baskiak Roskovec e cila u hap në vitin 2020, ka qenë aktive duke publikuar vazhdimisht aktivitet tē këshillit, përvetës transmetimit live të disa mbledhjeve.

Nuk kanë munguar as takimet direkte të këshilltarëve me banorët e Bashkisë dhe përcjellja e mendime tē tyre në mbledhjet e komisioneve dhe të këshillit.

Përsa i përket transparencës dhe konsultimeve publike në zbatim tē Rregullores së Konsultimeve Publike për vitin 2021 kemi realizuar 30 dëgjesa publike. Për shkak të pandemisë 2 prej dëgjesave i kemi realizuar online, të tjerat kanë qenë takime fizike në ambjente të caktuara dhe në terren. Po ta krahasojmë me vitin 2020 ku kishim zhvilluar 16 dëgjesa publike, për vitin 2021 kemi zhvilluar 14 dëgjesa publike më tepër, pra ka një rritje tē dukshme tē transparencës dhe konsultimit me komunitetin dhe grupet e interesit. Këshilli zhvilloi një toënhall, ku morën pjesë 52 persona, nga të cilët 42 meshkuj, 10 femra.

Dëgjesat publike janë realizuar në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë. Pavarësisht situatës në mënyrë specifike për Buxhetin dhe Paketen Fiskale për vitin 2022, si nga këshilli edhe nga kryetari i bashkisë janë realizuar dëgjesat publike në cdo fshat tē Njesive Administrative si dhe në Roskovec. Në dëgjesat publike është vërejtur një rritje e pjesëmarrjes së elementit gjinor femër. Gjatë vitit 2021 në dëgjesa kanë marrë pjesë afërsisht 600 qytetarë.

Në dëgjesat e zhvilluara janë bërë propozime dhe sugjerime shumë të vlefshme, kryesisht për buxhetin dhe paketen fiskale. Këshilli dhe Bashkia kanë vleresuar sugjerimet dhe propozimet e bëra nga qytetarët dhe janë angazhuar që ato të pasqyrohen në vendimmarrje. Theksojme se në Buxhetin e vitit 2022 janë përfshirë rekondimet tē dala nga dëgjesat publike.

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përvec ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruar nga ana e këshilltarëve në drejtim të administratës me rastin e shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2021 u realizuan dhe u paraqitën në këshill edhe disa informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra nga vetë këshilli.

Në këtë drejtim, edhe për vitin 2022, në planin e aktiviteteve të miratuar janë planifikuar një sëre informacionesh dhe raportesh nga të cilat një pjesë e mire janë edhe detyrime ligjore për tu paraqitur nga administrata e bashkisë dhe për tu shqyrtuar nga këshilli.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar se cilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar bashkëpunëtorët që asistojnë në aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Roskovec, projektin “BashkitëForța”, ftojmë të gjithë të bëhen pjesë përmirësimin e punës së këshillit në vazhdim.

Këshilli i Bashkisë Roskovec do të vazhdojë të punojë me përkushtim dhe përgjegjshmëri gjithmonë në shërbim të komunitetit.

Duke ju falenderuar dhe uruar punë të mbarë !

Sekretar i Këshillit

Arlinda Hajdini

